

*Flag a great opportunity!*

**VENDIM**

NR. 6 DATA 15/12 2022

**I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË  
“GREEN VIEW ALTERNATIVE INVESTMENT FUND” SHOQËRI KOMANDITE SIK**

**“MBI MIRATIMIN E RITJES SË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË “GREN VIEW  
ALTERNATIVE INVESTMENT FUND” SHOQËRI KOMANDITE SIK” DHE TRANSFERIMIT TË  
FONDEVE PËR EFEKT TË RITJES SË KAPITALIT”,**

Sot më datë 15 / 12 / 2022, në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Green View Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK, e cila bazuar në Statutin e Shoqërisë, në ligjin nr.56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”(i ndryshuar), bazuar në kompetencat që i jep ligji, si dhe për mbarëvajtjen e zhvillimit të punës;

**VENDOSËN:**

1. Të miratojnë rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë “Green View Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK, nëpërmjet derdhjes së kontributeve të reja në para në vlerën 20,000,000.00 (njëzet milion) lekë nga Ortaku i Pakufizuar, Banka Credins sh.a..
2. Me zbatimin si dhe ndjekjen e procedurave të këtij vendimi, ngarkohet Administratori i Shoqërisë “Green View Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK dhe Shoqëria Administruese e Fondeve “Credins Invest” sh.a..
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Mbledhja e datës 15 / 12 / 2022 u mbajt me pjesëmarrjen e:

Për Banka Credins sh.a. zotërues në 98.49 % të kapitalit themeltar:  
Z. Maltin Korkuti (përfaqësues i autorizuar i Banka Credins sh.a.)

Për Z. Arjan Hana zotërues në 1.51 % të kapitalit themeltar:  
Z. Arjan Hana

*Arjan Hana*

